



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DPSUMK

Adresa: "Sheshi Skënderbej", Nr.2, Tiranë

Tel/Fax: 04 259 333

Nr.

Prot.

Tiranë, më

2008

U D H Ë Z I M

Nr. 8 datë 21.7.2008

PËR

**MATERIALET DHE ARTIKUJT QERAMIK TË PËRCAKTUAR TË JENË NË KONTAKT
ME PRODUKTET USHQIMORE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", Kreu XI neni 41 "Objekti i kontrollit zyrtar të ushqimeve", nenit 76 të ligjit 9590 datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian dhe shteteve të tyre anëtare" dhe V.K.M. Nr. 463 datë 05.07.2006 "Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit" i ndryshuar

U D H Ë Z O J :

1. Ky Udhëzim do të zbatohet për migrimin e hekurit dhe kadmiumit nga artikujt qeramik të cilët në fazën e tyre përfundimtare janë përcaktuar të jenë ose janë në kontakt me produktet ushqimore.
2. "Artikuj qeramik" janë artikujt e prodhuar nga përzjerja e materialeve inorganike kryesisht me përmbajtje argjile ose silice në të cilën janë shtuar sasi të vogla të materialeve organike. Këtyre artikujve fillimisht u jepet një formë dhe forma e përfutur fiksohet përfundimisht me pjekje. Ato mund të jenë të glazuara, emaluara dhe/ose dekoruara.
3. Sasia e hekurit dhe kadmiumit e transferuar nga artikujt qeramik përcaktohet me test, kushtet e të cilit janë specifikuar në Shtojcën I bashkëlidhur këtij Udhëzimi, duke përdorur metodën e analizës të përshkruar në Shtojcën II të këtij Udhëzimi.
4. Kur një artikull qeramik konsiston në një enë qeramike të mbyllur me një kapak qeramik, kufiri i migrimit të hekurit dhe/ose kadmiumit nga kapaku qeramik është i njejtë me atë të aplikuar për enën. Ena dhe sipërfaqja e brendëshme e kapakut testohen në mënyrë të ndarë dhe nën të njejtat kushte. Shuma e dy niveleve të ekstrakteve të hekurit dhe/ose kadmiumit lidhet me sipërfaqen ose volumin e enës më vete.

5. Një artikull qeramik plotëson kërkesat e këtij Udhëzimi nëqoftëse sasi të e hekurit dhe/ose kadmiumit të ekstraktuara gjatë testimit të kryer sipas kushteve të dhëna në Shtojcën I dhe II nuk kalojnë kufijtë e mëposhtëm:

- Kategoria 1: artikujt që nuk mund të mbushen dhe artikujt që mund të mbushen, thellësia e brendëshme e të cilave, e matur nga pika më e ulët e planit horizontal duke kaluar nëpermjet skajit të sipërm, nuk kalon $25 \text{ mm Fe} = 0.8 \text{ mg/dm}^2$; $\text{Cd} = 0.07 \text{ mg/dm}^2$
- Kategoria 2: Të gjithë artikujt e tjerë të cilat mund të mbushen $\text{Fe} = 4.0 \text{ mg/l}$; $\text{Cd} = 0.3 \text{ mg/l}$
- Kategoria 3: Enët për gatim; enët për ruajtje dhe paketim që kanë një kapacitet jo më shumë se tre litra $\text{Fe} = 1.5 \text{ mg/l}$; $\text{Cd} = 0.1 \text{ mg/l}$

6. Kur një artikull qeramik nuk i kalon sasi të e mësipërme më shumë se 50%, do të pranohet se këto artikuj plotësojnë kërkesat e këtij Udhëzimi nëqoftëse të paktën tre artikujt të tjerë me të njëjtën formë, përmasa, dekorim dhe glazurë kanë qenë subjekt testimi sipas kushteve të dhëna në Shtojcën I dhe II të këtij Udhëzimi dhe sasia mesatare e hekurit dhe/ose kadmiumit të ekstraktuar nga këto artikuj nuk kalojnë kufijtë e vendosur me më shumë se 50%.

7. Në të gjithë fazat e marketingut, përfshirë edhe shitjen me pakicë, artikujt qeramikë të cilat nuk janë vendosur akoma në kontakt me produktet ushqimore shoqërohen me një deklaratë të shkruar sipas Udhëzimit të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr.10 datë 04.09.2007 "Për materialet në kontakt me ushqimin".

Deklarata lëshohet nga prodhuesi ose shitësi dhe duhet të përmbajë informacionin e dhënë në Shtojcën III të këtij Udhëzimi.

8. Dokumentacioni që vërteton përpuethshmërinë e artikujve qeramik me kufijtë e migrimit të hekurit dhe kadmiumit sipas pikës 5 të këtij Udhëzimi, i cili është bërë i vlefshëm nga prodhuesi ose importuesi, i jepet autoritetit kompetent me kërkesën e tij. Ky dokumentacion përmban rezultatet e analizave të kryera, kushtet e testit dhe emrin e adresën e laboratorit që ka kryer testimin.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Inspektoriati i Sigurisë Ushqimore dhe Laboratorët e Kontrollit Ushqimor për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

JEMIN GJANA

MINISTËR

SHTOJCA I

RREGULLAT BAZË PËR PËRCAKTIMIN E MIGRIMIT TË HEKURIT DHE PLUMBIT

1. Testi i lëngshëm (“simulant”)

4% (v/v) acid acetik, në tretësirë ujore i përgatitur i freskët.

2. Kushtet e testit

2.1. Testi kryhet në temperaturën $22 \pm 2^{\circ}$ C për 24 ± 0.5 orë.

2.2. Kur është për tu përcaktuar migrimi i hekurit, mostra mbulohet për tu mbrojtur në një mënyrë të përshtatëshme dhe mbahet e ekspozuar në kushte të një ndriçimi normal në laborator.

Në rastet kur përcaktohet migrimi i kadmiumit dhe i hekurit, për të përcaktuar migrimin e kadmiumit mostra mbulohet në mënyrë të tillë që të sigurohet që sipërfaqja që do të testohet të mbahet në errësirë të plotë.

3. Mbushja

3.1. Mostrat të cilat mund të mbushen

Artikujt mbushen me tretësirë acidi acetik 4% (v/v) në një nivel jo më shumë se 1 mm nga pika e derdhjes: distanca matet nga buza e sipërme e mostrës.

Mostrat me buzë të sheshtë ose pjerrësi të lehtë mbushen në mënyrë të tillë që distanca ndërmjet sipërfaqes së lëngut dhe pikës së derdhjes të jetë jo më shumë se 6 mm e matur përgjatë buzës së pjerrët.

3.2. Mostrat të cilat nuk mund të mbushen

Sipërfaqja e mostrave të cilat nuk janë përcaktuar të jenë në kontakt me produktet ushqimore fillimisht mbulohet me një shtresë të përshtatëshme mbrojtëse të aftë për ti rezistuar veprimit të tretësirës së acidit acetik 4% (v/v). Mostra pastaj zhytet në një enë që përmban një volum të njohur të tretësirës së acidit acetik në mënyrë të tillë që sipërfaqja e përcaktuar të jetë në kontakt me produktet ushqimore të jetë plotësisht e mbuluar nga lëngu i testit.

4. Përcaktimi i madhësisë së sipërfaqes

Madhësia e sipërfaqes në kategorinë e I^ë është e barabartë me madhësinë e meniskut të formuar nga sipërfaqja e lirë e lëngut e fituar sipas rregullave të kërkuara të mbushjes të dhëna në pikën 3 të kësaj Shtojce.

SHTOJCA II

METODAT E ANALIZËS PËR PËRCAKTIMIN E MIGRIMIT TË HEKURIT DHE KADMIUMIT

1. Objekti dhe fusha e aplikimit

Përcaktimi i metodave të lejuara për përcaktimin e migrimit të hekurit dhe kadmiumit.

2. Parimi

Përcaktimi i migrimit specifik të hekurit dhe/ose kadmiumit kryhet me metodë instrumentale analizimi që plotëson kriteret e dhëna në pikën 4 të kësaj Shtojce.

3. Reagentët

- Të gjithë reagentet duhet të kenë cilësi analitike, në të kundërt të specifikohet.
- Kur referohet uji, gjithmonë duhet të kuptohet ujë i distiluar ose ujë me cilësi ekuivalente.

3.1. Acid acetik 4% (v/v), në tretësirë ujore.

Shtohen 40 ml acid acetik glacial në ujë dhe çohet deri në 1000 ml.

3.2. Tretësirat bazë

Tretësirat bazë të përgatitura në tretësirë acidi acetik 4% (v/v), sipas pikës 3.1 të kësaj Shtojce, përmbajnë respektivisht 1000 mg/litër hekur dhe të paktën 500 mg/litër kadmium.

4. Kriteri i metodës instrumentale të analizës

4.1. Kufiri i zbulimit për hekurin dhe kadmiumin duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se:

- 0.1 mg/litër për hekurin,
- 0.02 mg/litër për kadmiumin.

Kufiri i zbulimit përcaktohet si përqendrim i elementit në tretësirën e acidit acetik 4% (v/v), sipas pikës 3.1 të kësaj Shtojce, e cila jep një sinjal të barabartë me dyfishin e zhurmës së instrumentit.

4.2. Kufiri i përcaktimit të sasisë për hekurin dhe kadmiumin duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se:

- 0.1 mg/litër për hekurin,
- 0.02 mg/litër për kadmiumin.

4.3. *Nxjerrja.* Nxjerrja e hekurit dhe kadmiumit të shtuar në 4% të tretësirës së acidit acetik, sipas pikës 3.1. të kësaj Shtojce, duhet të jetë sa 80 – 120% e sasisë së shtuar.

4.4. *Specifikim.* Metoda instrumentale e analizës së përdorur të jetë e lirë nga matrica dhe interferencat spektrale.

5. Metoda

5.1. Përgatitja e mostrës

Mostra duhet të jetë e pastër dhe e lirë nga yndyrnat dhe lëndët e tjera që ndikojnë në test.

Mostra lahet në një tretësirë që përmban detergjent të lëngët që përdoret në ekonomite shtëpiake në temperaturë afërsisht 40⁰ C. Shpëlarja e mostrës bëhet fillimisht me ujë çesme dhe më pas me ujë të distiluar ose ujë me cilësi ekuivalente. Kullohet dhe thahet me qëllim që të parandalohet çdo njollë. Sipërfaqja që do të testohet nuk duhet të preket pas pastrimit.

5.2. Përcaktimi i hekurit dhe/ose kadmiumit

- Mostra e përgatitur sipas pikës 5.1. të kësaj Shtojce testohet sipas kushteve të dhëna në Shtojcën I të këtij Udhëzimi.

- Përpara marrjes së tretësirës së testit për përcaktimin e hekurit dhe/ose kadmiumit, përmbajtja e mostrës homogjenizohet me një metodë të përshtatëshme, e cila parandalon çdo humbje të tretësirës ose gërryerje të sipërfaqes që do të testohet.

- Kryhet një test i bardhë me reagentët që do të përdoren për secilën seri të përcaktimit.

- Përcaktimi i hekurit dhe/ose kadmiumit kryhet në kushtë të përshtatëshme.

SHTOJCA III

DEKLARATA E PËRPUETHSHMËRISË

Deklarata e shkruar sipas pikës 7 të këtij Udhëzimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

1. identitetin dhe adresën e kompanisë e cila ka prodhuar artikullin qeramik të përfunduar dhe të importuesit;
2. identitetin e artikullit qeramik;
3. datën e deklaramit;
4. konfirmimin që artikulli qeramik plotëson kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr.10 datë 04.09.2007 "Për materialet në kontakt me ushqimin".

Deklarata e shkruar lejon një identifikim të lehtë të mallit për të cilin ajo është lëshuar dhe leshohet e re kur ndryshime thelbësore në produkt sjellin ndryshime në migrimin e hekurit dhe kadmiumit.